

Barazia gjinore dhe zgjedhjet në Shqipëri: Zgjedhjet vendore

Dispozitat e paraqitura me ndryshimet ligjore të vitit 2020 garantojnë një kuotë gjinore prej 50% për këshillat vendorë në listat e candidateve/ëve që kërkohen për të përfaqësuar në mënyrë të barabartë gratë dhe burrat dhe kandidatet/ët e gjinive të ndryshme të alternuara në listë. Sanksioni i Kodit Zgjedhor për refuzimin e listës së candidateve/ëve për mosrespektim të kuotës gjinore zbaton parimin e barazisë në zgjedhjet për këshillat vendorë (nenet 67/6, 67/7 dhe 175). Nga ana tjetër, për kandidatet/ët për kryetar/e bashkie, nuk ka kërkesë për kuotë gjinore.

Këto përmirësime u reflektuan edhe në zgjedhjet e fundit vendore të majit 2023, kur nga 23 763 candidate/ë për këshilla vendorë, 11 828 ishin gra (49.8 për qind). Megjithatë, misioni i monitorimit të zgjedhjeve ka vënë në dukje se në disa bashki kuota nuk është respektuar dhe zbatuar gjithmonë (duke rezultuar në gjithsej 37 candidate gra më pak. Gjithsesi, në përgjithësi, gratë ishin të përfaqësuara mirë në listat e candidateve/ëve.²⁷ Përkundrazi, mungesa e detyrimit për të respektuar çdo kuotë gjinore për kandidatet/ët për kryetar/e bashkie çoi në vetëm 15 gra candidate mes 144 candidateve/ëve në total (10 për qind), nga të cilat u zgjodhën 8. Ato përfaqësojnë 13% të numrit të përgjithshëm të kryetareve/ëve të bashkive, duke mos shënuar asnjë progres në krahasim me zgjedhjet e mëparshme vendore.

Burimi: KQZ/UNWomen. Informacion paraprak mbi proceset zgjedhore në Shqipëri